

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish krerëve UÇK - Serbia pritet ta përdorë verdiktin e Speciales për ofensivën e re anti-Kosovë
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917897/serbia-pritet-ta-perdore-verdiktin-e-speciales-per-ofensiven-e-re-anti-kosove/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 18:28:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 18:09:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5d2eba991646c564ec5607c64d90b32c915daf2efff8de837fe000763daa00b7
TEKSTI	b3544248c24e8bdf8c19b650e9be2e79554abb46d861b112b814598ac8c8eb95
PAMJA	21d7407dc147c826175050256f44b6f46739d0ea2a50e8c3bec35ed68804cf2e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e983019d7869963cfa0af1a3bdb4e53de2b602da5d6ad7ac121a32ec5215d2b3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	12839dc4b023db7c55325e9d2ee92462b471b26279290faf1035fe327d267353
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e983019d7869963cfa0af1a3bdb4e53de2b602da5d6ad7ac121a32ec5215d2b3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA

Nga Çim Peka-Tradhtia që s'e panë tu ardhë



më të lexuarat

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Kur Albin Kurti paralajmëronte Kuvendin e Kosovës: VV nuk e njeh Gjykatën Speciale, ne nuk do të dorëzojmë luftëtarët e UÇK

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

Serbia pritet ta përdorë verdiktin e Speciales për ofensivën e re anti-Kosovë

20:09, 19/09/2026

Verdikti dënues i Gjykatës Speciale ndaj udhëheqësve të UÇK-së pritet të jetë pjesë e narrativës së Serbisë për ta luftuar Kosovën, gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në Prishtinë është shprehur drojë se Beogradi zyrtar do të nisë ofensivë diplomatike me synim dëmtimin e legjitimitetit ndërkombëtar të shtetit.

Në Prishtinë është shprehur drojë se në Sesionin e 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që zhvillohet gjatë javës së ardhshme, Serbia do ta shfrytëzojë verdiktin dënues nga Gjykata Speciale, për ta forcuar narrativën kundër Kosovës.

Presidenti i këtij shteti, Aleksandër Vuçiç, ka paralajmëruar se gjatë adresimit në Asamble, do të flasë për 30-vjeçarën e fundit të Serbisë, periudhë që përfshin edhe vitet e luftës në Kosovë.

Sipas profesorit të së drejtës ndërkombëtare, Arben Hoti, Serbia pritet ta përdorë aktgjykimin e Speciales si argument në përpjekjet e saj për ta dëmtuar imazhin dhe pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

"Kjo është më se e sigurt sepse Serbia deri më tani ka shpikur i thëncin argumente, për ta prezantuar Kosovën sa më keq që është e mundur. Nuk kam asnjë dilemë që ata do të përdorin këtë argument për të luftuar, për të vazhduar luftën kundër Kosovës", ka thënë Hoti.

Pritje të këtyllë ka shprehur edhe njohësi i çështjeve ndërkombëtare, Fatmir Bilalli.

"Delegacioni serb dhe personal Vuçiçi me siguri në ekspozenë e vetë do të fusë, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë. Do të bëjë lobim për të penguar njohjen, por eventualisht për të rritur edhe numrin e çnjohjeve. Dhe kjo do të jetë ofensiva e re diplomatike e Serbisë e cila është fatkeqësisht e ka një aktgjykim që mund ta keqpërdorë", ka deklaruar Bilalli.

Për të marrë pjesë në javën e Nivelit të Lartë të këtij sesioni të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, për në New York kanë udhëtuar kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca. Por, ata nuk mund t'i adresohen Asamblesë, meqë Kosova nuk është anëtare e OKB-së. Takime pritet të zhvillojnë vetëm në margjina të kësaj ngjarjeje.

Qeveria e Shqipërisë nuk u është përgjigjur pyetjeve nëse në New York, Tirana

zyrtare do të kundërpërgjigjet pretendimeve të Serbisë lidhur me Kosovën, pas vendimit të Speciales.

Gjykata me seli në Hagë dënoi për krime lufte Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 vjet burgim, e Rexhep Selimi me 13 vjet burgim. Ata janë shpallur të pafajshëm për krime kundër njerëzimit. /Koha.net/

© SYRI.net

Lexo edhe:



Edhe një i vdekur nga virusi i Nilit Perëndimor në Kosovë, shtatë të infektuar



Kurti: Është konfirmuar identiteti i tri viktimave nga varret masive në Zubin Potok, i përkasin 'Grupit të Intelktualëve'



Josphe: Jam i habitur me lartësinë e dënimeve të Hagës, është pozitive që u shpallën të pafajshëm për krime kundër njerëzimit

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

Trupi gjykues: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmori hapa

Diaspora ngrihet sot në protesta në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



'Jo në emrin tim', mijëra qytetarë në natën e tretë rresht kundërshtojnë vendimin e Hagës



Kurti udhëton drejt New Yorkut, takime me liderë botërorë dhe diasporën shqiptare



Avokati i Thaçit reagon me kritika të forta ndaj Gjykatës



Christopher Hill: S'e besoj se Thaçi është përfshirë në vepra të paligjshme



BE thirrje Kosovës e Shqipërisë për
përmbytje: Specialja jep drejtësi të
paanshme

Kryeministri Kurti udhëton për në
SHBA

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.